



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Nr. 7153/1 prot.

Vlorë, më 23.04.2026

PROCESVERBAL ARGUMENTUES

“PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMIT PËR ZONËN E PLAZHEVE, TË ADMINISTRUARA DHE TË TARIFUAR NGA NJËSIA E VETËQEVERISJES VENDORE”

Të nderuar Këshilltar!

Qëllimi i këtij procesverbali:

Në kuadër të mbarëvajtjes së sezonit turistik për vitin 2026 në plazhet e Bregdetit të Vlorës si dhe në zbatimin dhe implementimin e Vendimit nr.649 datë 16.10.2024 Për Miratimin e Rregullores ”Për Kushtet dhe Kriteret e Ushtrimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit”, i ndryshuar, në ligjin 93/2015 ”Për Turizmin” parashikojnë kushte dhe kriteret të reja ligjore edhe për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit, që kanë si qëllim parësor reflektimin e këtyre kërkesave të reja ligjore, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe standardeve për pushuesit nëpërmjet rritjes së nivelit të sigurisë në plazhe, shtimin e hapësirave të plazheve publike, vendosjen dhe ruajtjen e kushteve higjienike si dhe mbrojtjen nga ndotjet dhe dëmtimet në plazhet pranë deteve.

➤ **Baza ligjore për vendosjen e tarifës**

- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 , neni 9.1 pika 1/a dhe b neni 23, pika 9, neni 64 pika “a” dhe “gj.”
- Ligji Nr.93/2015 datë 27.07.2015 “ Për turizmin”
- Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.
- VKM Nr.60 datë 28.01.2026 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.649 datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit.
- VKB-së Nr.96 datë 07.12.2023 “ Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë “, i ndryshuar me VKB-në Nr.105 datë 18.12.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime”

-VKB-së Nr.25, datë 28.02.2026 “ Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Vlorë.

Referuar çmimit të propozuar në Këshillin e datës 20.04.2026 prej 500 lekë ju sqarojmë si më poshtë arsyen pse nuk mund të vendoset çmimi 500 leke për çiftin çadër shezllon:

1. Çmimi 700 lekë është një vlerë e arsyeshme e justifikuar ekonomikisht ku krahasuar me këtë çmimi 500 lekë i cili nuk mbulon kostot reale të ofrimit të shërbimit.
2. Çmimi nuk është një shifër por një vlerë e cila duhet të mbuloi të gjitha shpenzimet e dukshme dhe të padukshme (tvsh,paga,sigurime,pastrimi ditor,mirëmbajtje ditore,amortizime,investime etj.)
3. Çmim më i ulët do të sillte një standart më të ulët ,pastrim më të dobët,mungesë kontrolli, mangësi në shërbim , numër më i ulët punonjësish,jo mbulim me vrojtues gjithë sezonin.
4. Sezoni turistik zhvillohet në një periudhë të shkurtër dhe çmimi prej 500 lekë nuk mbulon shpenzimet , për të lejuar që të investohen në shërbime cilësore vitin tjetër.
5. Çmimi prej 500 lekë i cili është nën kosto e ul cilësinë dhe nxit informalitetin duke dëmtuar qytetarin në një afat mesëm.
6. Çmimi 500 lekë rezulton nën nivelin minimal ekonomik duke mos mbuluar kostot në kushte normale dhe dukë krijuar rrezik të vazhdueshëm humbje.
7. Çmimi prej 500 lekë nuk do të përballonte minimumi as qeran që do të duhet të paguajmë për shezllon vitin e parë, duke qënë se koha është e shkurtër dhe nuk mund të kryhet investim vetë pasi dhe vlera është përllëgaritur mbi 60 milion lekë të reja .Në këto kushte e vetmja mënyrë është qeramarrja e shezllonëve të cilët bizneset i kanë dhe nuk mund ti përdorin si pasoj e përfundimit të kontratës të cilën nuk mund ta rinovojnë në zbatim të VKM 649 datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit.
8. Duke i shtuar shpenzimeve dhe ditët boshë me nivel shfrytëzimi të ulët si pasoj e kushteve atmosferike , çmimi prej 500 lekë është tejet i papërballueshëm për 90 ditët e sezonit.
9. Çmimi prej 500 lekë mund të duket i ulët ,por nuk mund të përballoj as kostot minimale të sezonit.
10. Kostot për çadër sipas analizës ekonomike pa tvsh dalin 438 lekë ndërkohë që çmimi pa tvsh për 500 lekë është 416 lekë,shifra që tregojnë mjaftë qartë se çmimi nuk i mbulon kostot dhe diferenca prej $416-438 = - 22$ lekë tregon se as kostot minimale të shpenzimeve të domosdoshme nuk mbulohen.
11. Për të mos analizuar dhe faktin që shërbimi do të jetë i dobët, numri i punonjësve do të ulej dhe do të bënte të pamundur përballimin e menaxhimit dhe mirëmbajtjes gjatë gjithë sezonit duke dëmtuar kështu punën dhe imazhin e qytetit të Vlorës.

Drejtor
Bruna Bisholla



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KRYETAR

Nr. 7153 prot.

Vlorë, më 14.04 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ datë _____ 2026

**“PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMIT PËR ZONËN E
PLAZHEVE, TË ADMINISTRUARA DHE TË TARIFUAR NGA NJËSIA E
VETËQEVERISJES VENDORE”**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 1 neni 9 pika 1 nënpika1.1 i ndryshuar, Ligjit Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Ligjit Nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, Ligjit Nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar, Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. V.K.M -së Nr.321, datë 28.05.2014 “Për sigurinë në det, plazhe, në ujrat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”, i ndryshuar, V.K.M -së Nr.845, datë 28.10.2020”Për miratimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e aktiviteteve turistike detare, që kryhen nëpërmjet mjeteve lundruese për qëllime turistike dhe argëtimi”, V.K.M-së Nr 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar, neni6/1, në VKB.25, datë 28.02.2026 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Vlorë, për vitin 2026 dhe tarifës së shërbimit për zonën e plazheve publike të administruara dhe të tarifuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore” si dhe në relacionin me nr. 7145 prot., datë 14.04.2026 të paraqitur nga grupi i punës;

V E N D O S I:

1. Të miratojë Tarifën e ofrimit të shërbimit për zonën e plazheve të administruara dhe të tarifuar nga Njësia e Vetëqeverisjes Vendore.
2. Tarifa për ofrimin e shërbimeve në plazhet publike të tarifuar nga Njësia e Vetëqeverisjes vendore të jetë 700 lekë.
3. Ngarkohet Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Policia Bashkiake, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Tarifa për zënien e hapësirës publike me qëllim biznesi për zonën e Plazhi i Vjetër-Zvërnec dhe Uji i Ftohtë-Radhimë-Orikum që do ti referohet tarifës së përcaktuar në VKB-në nr. Nr. 96, datë 07:12.2023 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë, per vitin 2024", mbeten të pandryshuara.
5. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 55 pika 6.

KRYETAR

Brunilda Mersini

ME URDHER DELEGIMI

Joljana Llanaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Nr. _____ prot.

Vlorë, më _____, 2026

RELACION

“PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMIT PËR ZONËN E PLAZHEVE, TË ADMINISTRUARA DHE TË TARIFUAR NGA NJËSIA E VETËQEVERISJES VENDORE”

Të nderuar Këshilltar!

Po ju paraqesim këtë projektvendim “Për miratimin e tarifës së ofrimit të shërbimit për zonën e plazheve, të administruara dhe të tarifuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore”

Qëllimi i këtij projektvendimi:

Në kuadër të mbarëvajtjes së sezonit turistik për vitin 2026 në plazhet e Bregdetit të Vlorës si dhe në zbatimin dhe implementimin e Vendimit nr.649 datë 16.10.2024 Për Miratimin e Rregullores “Për Kushtet dhe Kriteret e Ushtimit të Veprimtarisë së Stacionit të Plazhit”, i ndryshuar, në ligjin 93/2015 “Për Turizmin” parashikojnë kushte dhe kriteret të reja ligjore edhe për ushtimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit, që kanë si qëllim parësor reflektimin e këtyre kërkesave të reja ligjore, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe standardeve për pushuesit nëpërmjet rritjes së nivelit të sigurisë në plazhe, shtimin e hapësirave të plazheve publike, vendosjen dhe ruajtjen e kushteve higjienike si dhe mbrojtjen nga ndotjet dhe dëmtimet në plazhet pranë deteve.

➤ **Baza ligjore për vendosjen e tarifës**

- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 , neni 9.1 pika 1/a dhe b neni 23, pika 9, neni 64 pika “a” dhe “gj.”
- Ligji Nr.93/2015 datë 27.07.2015 “ Për turizmin”
- Ligji Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.
- VKM Nr.60 datë 28.01.2026 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.649 datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit.

- VKB-së Nr.96 datë 07.12.2023 “ Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë “, i ndryshuar me VKB-në Nr.105 datë 18.12.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime”

-VKB-së Nr.25, datë 28.02.2026 “ Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Vlorë.

❖ **Në VKB-në Nr.96 datë 07.12.2023 “ Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë”:**

Vendimi aktual i Këshillit Bashkiak Nr.96 datë 07.12.2023 “ Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë” kreu II, pika 1 a/2 Tarifat për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi Plazh citon shprehimisht se sipas zonave tarifat janë si më poshtë:

NR	EMERTIMI	VLERA
1	Për zenien e hapësirave publike ne plazhin e Nartës dhe Plazhin e Vjetër	
	për njësit akomoduese(hotel,motel,bujtin,etj)	400 lekë /m2 /sezon
	për subjektet për stacion plazhi,bare restorante	500 lekë /m2 /sezon
2	Për zenien e hapësirave publike ne plazhin e Lungomare I (fillimi lungomare deri te fushat e sportit)	
	për njësit akomoduese(hotel,motel,bujtin,etj)	600 lekë /m2 /sezon
	për subjektet për stacion plazhi,bare restorante	700 lekë /m2 /sezon
3	Për zenien e hapësirave publike ne plazhin nga fushta e sportit - Pashaliman Oriku	
	për njësit akomoduese(hotel,motel,bujtin,etj)	650 lekë /m2 /sezon
	për subjektet për stacion plazhi,bare restorante	750 lekë /m2 /sezon

❖ **Bazuar në vendimin nr.649 datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” neni 2,pika d,f ku citohet se:**

d)“Plazh publik”, zona e plazheve të lejuara dhe të administruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të hapura për përdorim publik që ofrojnë kërkesa minimale për sigurinë dhe higjienën

f) “Zonë shërbimesh”, zona ku ndodhen shërbimet higjieno-sanitare, kabinat e veshjes dhe baret.

Sipas Neni 3 , pika 1/”a” , 2 ku citohet se :

1) Plazhet, në bazë të vijës së bregut të detit ose të liqenit dhe të karakteristikave të tjera natyrore, ndahen në plazhe të tipit A, B, AB e C:

- a) Plazh i tipit A është plazhi kryesisht me përbërje ranore dhe me gjerësi të konsiderueshme të brezit të plazhit, i cila nuk është më e vogël se 60 m (gjashtëdhjetë) vijë perpendikulare me vijën e bregut të detit ose të liqenit;
- 2) Hapësirat e plazheve të lejuara, të cilat nuk janë dhënë në përdorim për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të plazhit janë për përdorim publik dhe administrohen, menaxhohen e mirëmbahen nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Neni 4 Harta e përgjithshme për plazhet e lejuara

1. Njësiti e vetëqeverisjes vendore përgatit hartën e përgjithshme për plazhet e lejuara. Kjo hartë përmban, si më poshtë vijon:

a) hapësirat e plazhit për të ushtruar veprimtari, si stacion plazhi;

b) hapësirat e plazhit publik;

c) hapësirën ujore të lejuar për notim, zonë e rrethuar me bova;

ç) vendqëndrimet e mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre.

2. Për përcaktimin e vendqëndrimeve dhe korridoreve të lëvizjes, të përcaktuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij neni, njësiti e vetëqeverisjes vendore bashkëpunojnë me Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe me strukturat e Policisë Kufitare.

3. Ndarja e sipërfaqes së plazhit të lejuar, si plazh privat/publik, do të kryhet sipas gjatësisë në vijë lineare të hartës së propozuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse, në mënyrë 3 perpendikulare me vijën e bregut të detit/liqenit, ku në çdo 1000 m vijë lineare, 300 m vijë linear plazh përcaktohen si parcela publike, shpërndarja e të cilave në hartë vlerësohet nga njësia e qeverisjes vendore, rast pas rasti, sipas tipologjisë së secilit plazh.

4. Harta e përgjithshme e plazheve propozohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse dhe miratohet brenda muajit tetor nga Komiteti i Menaxhimit të Sezonit Turistik.

5. Agjencia Kombëtare e Bregdetit, në bashkëpunim me njësiti e vetëqeverisjes vendore, deri në datën 1 maj, të çdo viti, lidh të gjitha kontratat e qirasë për përdorimin e stacionit të plazheve. 6. Plazhet, për të cilat nuk është lidhur kontratë deri në datën e përcaktuar në pikën 5, të këtij neni, funksionojnë si plazhe publike dhe administrohen/menaxhohen e mirëmbahen nga njësiti e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

Neni 6 ‘Njësia e Vetëqeverisjes Vendore’ citohet se:

Njësia e vetëqeverisjes vendore (në vijim “NJVV”) është përgjegjëse, për:

a) administrimin dhe menaxhimin e hapësirave të plazhit publik;

b) pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të plazhit;

c) pajisjen me infrastrukturën mbështetëse dhe ndarjen me sinjalistikën përkatëse të plazheve, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ç) vendosjen e sinjalistikës së dallueshme për çdo tipologji plazhi, që është plazh publik;

d) mbledhjen e detyrimeve të qirasë për çdo vit;

dh) miratimin e vendqëndrimeve të mjeteve lundruese dhe korridoret e lëvizjes së tyre, pasi të ketë marrë mendimin e Drejtorisë së Përgjithshme Detare.

2. NJVV-ja, në rast se menaxhon hapësira të konsiderueshme, si plazhe publike, garanton kushtet minimale të stacioneve të plazhit, sipas tipologjisë dhe kërkesave të sigurisë, të parashikuar në këtë rregullore. Pjesa tjetër e plazhit publik mirëmbahet nga NJVV-ja, duke siguruar vendosjen e tabelave informuese, sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.

3. Policia Bashkiake e NJVV-së përkatëse është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe ruajtjen e hapësirave të plazheve publike, si dhe marrjen e masave të menjëhershme për rastet e parashikuara në pikat 5 dhe 6, të nenit 8, të kësaj rregulloreje.

Neni 8 Kushtet minimale të stacionit të plazhit, sipas tipologjisë së plazhit

1. Kushtet minimale, që duhet të përmbushë një stacion plazhi, në plazhet e tipit A, janë, si më poshtë vijon:
 - a) për çadrat dhe ndenjësiet e pushuesve të respektohet një distancë prej të paktën 10 (dhjetë) m nga vija e bregut të detit/liqenit;
 - b) hapësira prej 2.5 (dy pikë pesë) m përpara brezit të parë të çadrave të jetë e lirë për t'u shfrytëzuar nga publiku;
 - c) hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) nuk duhet të jetë më e vogël se 3 (tre) m në linjë horizontale me vijën e ujit, si dhe jo më e vogël se 2.5 (dy pikë pesë) m në linjë vertikale me vijën e ujit;
 - ç) të ketë në dispozicion të pushuesve 1 (një) dush me ujë të ëmbël;
 - d) të jetë i pajisur me shërbime higjienike, minimalisht të ketë 1 tualet, të ndarë në njësi për femra dhe meshkuj, dhe 1 (një) për njerëzit me aftësi të kufizuar; njësia për njerëzit me aftësi të kufizuar mund të përfshihet në secilën njësi për femra dhe meshkuj, duke rritur sipërfaqen e këtyre njësive të shërbimit, në dimensionet maksimale 1,80 m x 1,80 m;
 - dh) të ketë kabina zhveshjeje, sipërfaqja totale e kabinave të zhveshjes nuk duhet të jetë më e vogël se 1 (një) % e sipërfaqes së hapësirës së plazhit të dhënë në përdorim;
 - e) të jetë i pajisur me zonën e ndihmës së shpejtë në shërbim të pushuesve, si dhe me pajisjet përkatëse për dhënie të ndihmës së shpejtë për pushuesit; ky ambient duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm dhe i identifikueshëm e të lihen korridore të lira kalimi për transportin, në raste emergjence;
 - ë) prania e tabelave informuese, të vendosura në vende të dukshme, me numrat e telefonit të ambulancës, policisë, zjarrfikëses, Kapitenarisë së Portit, Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare;
 - f) të jetë i pajisur me kontejnerë dhe kosha me kapak për hedhjen e mbeturinave;
 - g) çdo çadër duhet të jetë e pajisur me 2 (dy) krevate plazhi; gj) të afishojë kriteret dhe kushtet e sigurisë së shëndetit dhe jetës për aspektet teknike të veprimtarisë së stacionit të plazhit;
 - h) të ekspozojë në vend të dukshëm për publikun emrin e biznesit, si dhe procedurën e ankimit të paktën në gjuhët shqipe dhe angleze;
 - i) të ekspozojë dukshëm listat e çmimeve për produktin dhe shërbimin, që ofron të paktën në gjuhët shqipe dhe angleze.
 - j) stafi që shërben pranë stacioneve të plazhit të ketë uniforme dalluese;
 - k) të zbatojë kodin e etikës globale në fushën e turizmit;
 - l) detyrimin të mirëmbajtjes dhe të parandalojë ndotjen e hapësirës së plazhit që ka marrë në përdorim nëpërmjet shërbimit për pastrimin dhe mirëmbajtjen e stacionit të plazhit çdo ditë, në mëngjes dhe në mbrëmje pas mbylljes së plazhit. Po ashtu, gjatë orarit të hapjes së stacionit të plazhit duhet të sigurohet vazhdimësia e pastërtisë dhe boshatisja e koshave të mbeturinave;
 - ll) në të gjithë territorin e plazhit të ndalohet vendosja e elementeve ndarëse, gardhe apo të tjera të ngjashme me to.

Neni 9 Kërkesat për sigurinë në stacionet e plazhit

1. Të gjitha stacionet e plazhit kanë detyrimin e vendosjes, mirëmbajtjes dhe ruajtjes së kushteve higjienike dhe të sigurisë për jetën, të caktuara në këtë rregullore, si dhe kanë detyrë të ruajnë pastërtinë e detit dhe bregut të detit për zonën para stacionit të plazhit, si dhe ta mbrojnë atë nga ndotjet e dëmtimet me shpenzimet e tyre.
2. Kërkesat për sigurinë, të përcaktuara në këtë nen, zbatohen edhe për plazhet publike.
3. Të gjitha stacionet e plazhit duhet të garantojnë shërbimin me vrojtues plazhi përgjatë gjithë kohës që subjekti ushtron aktivitetin e tij, për çdo 80 (tetëdhjetë) m vijë lineare bregdetare. Për stacionet e plazhit, me vijë lineare bregdetare mbi 80 (tetëdhjetë) m, pajisjen me pika vrojtimi për çdo fraksion 80 (tetëdhjetë) m linear. Edhe stacionet e plazhit me vijë lineare bregdetare nën 80 (tetëdhjetë) m kanë detyrimin të kenë vrojtues plazhi.
4. Të gjitha stacionet e plazhit duhet të kenë:
 - a) sinjalizimin dhe kufizimin me bova, me diametër 22 cm, me ngjyrë të kuqe, të lidhura me litar pluskues me njëra-tjetrën, çdo 30–50 m të hapësirës ujore përpara stacionit të plazhit të dedikuar për not, e cila duhet të jetë deri në:
 - i. 200 (dyqind) m nga bregu për plazhet e tipit A;
 - b) sinjalizimin e zonave të përdorimit të mjeteve lundruese për argëtim, zonat për përdorimin dhe vendqëndrimin e mjeteve lundruese me ose pa motor, jashtë zonave të përcaktuara për not sipas shkronjës “a”, më sipër, duhet të jenë të kufizuara, duke ofruar vende për qëndrim në tokë dhe bova për përcaktimin e vendqëndrimeve dhe korridoreve për afrimin dhe parkimin në tokë të mjeteve ujore me ose pa motor. Në zonat e përdorimit dhe vendqëndrimeve të mjeteve lundruese 8 për argëtim, aktivitetet e notimit janë të ndaluara. Sinjalizimin me tabela informuese në shqip dhe në anglisht, në vend të dukshëm pranë bregut të detit “Zonë e ndaluar për notim” dhe “No swimming area”;
 - c) vendosjen e flamujve me shklop, çdo ditë, gjatë sezonit të verës; subjekti që ushtron veprimtarinë e stacionit të plazhit duhet të vendosë një flamur, në përputhje me kushtet e motit dhe të detit, i cili mund të ndryshohet gjatë ditës, nëse ndryshojnë kushtet e motit apo të detit, si më poshtë vijon:
 - i. flamur i gjelbër – lejohet notimi;
 - ii. flamur i verdhë – notim me masa mbrojtëse;
 - iii. flamur i kuq – ndalohet notimi. Në shklopin e flamurit duhet të ketë edhe një tabelë sqaruese në shqip dhe anglisht për sinjalistikën me flamur dhe me informacion për kushtet e plazhit. Shkopi i flamurit duhet të jetë 3.5 m i lartë, i dukshëm në të gjithë zonën.
 - ç) pajisjen e çdo stacioni të plazhit me pikë vrojtimi
 - i. të jetë e vendosur në pozicion qendror, referuar strukturës së stacionit të plazhit ose vijës bregdetare në përdorim;
 - ii. të jetë e avancuar në krahasim me vijën e parë të çadrave;
 - iii. të ketë një fushë pamjeje dhe veprimi të lirë; iv. të jetë mbulesa e çadrës ose tendës së pikës së vrojtimit me pëlhurë të kuqe, lehtësisht e identifikueshme, ku të shkruhet qartë “VROJTUES PLAZHI”/ “LIFEGUARD”.
 - d) pajisjen e plazheve publike me pika vrojtimi, pajisjet e të cilave përcaktohen në shtojcën nr.2, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Distanca për pajisjen me pikavrojtimi në këto plazhe, për aq sa është e mundur, do të jenë sa distancat e parashikuara për pikat e vrojtimit në stacionet e plazhit dhe duhet të ketë lartësi 3 m dhe fushë pamjeje e veprimi të lirë;
 - dh) garantimin e shërbimit me vrojtues plazhi në çdo “stacion plazhi” dhe “plazh publik”. Vrojtuesi i plazhit punësohet nga subjekti publik dhe privat që ka në

përdorim/administrim hapësirën e plazhit dhe duhet të garantohet përgjatë gjithë periudhës së ushtrimit të veprimtarisë së plazhit. Në mugesë të shërbimit me vrojtues plazhi, struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e turizmit merr masa administrative në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin dhe legjislacionin në fuqi për turizmin.

6. Për plazhet publike, të cilët administrohen nga njësitë vendore dhe plazhet e tipit C, në të cilat nuk mund të ofrohen kriteret e sigurisë, duhet të vendosen tabela informuese lehtësisht të dallueshme, me mbishkrime (shqip dhe në anglisht) “KUJDES! – KY PLAZH NUK KA VROJTUES PLAZHI” / “ATTENTION! - THIS BEACH HAS NO LIFEGUARD”.

7. Çdo stacion plazhi dhe pikë vrojtimi duhet të ketë të afishuar:

7.1. Kanalet për komunikim emergjence, si:

a) shërbimi i urgjencës mjekësore;

b) Policia e Shtetit dhe strukturat përgjegjëse për kufirin në Policinë e Shtetit;

c) zjarrfikëset;

ç) Kapitenaria Detare;

dh) Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare.

7.2. Në mënyrë të dukshme, këshillat drejtuar pushuesve, në gjuhën shqipe dhe angleze, si më poshtë vijon:

a) Noto vetëm në zonat e autorizuara dhe me sinjalistikë;

b) Respekto flamurin dhe informacionin e afishuar;

c) Ndalohet notimi nën ndikimin e alkoolit apo drogave;

ç) Mos noto, nëse ke ndonjë problem fizik;

d) Pusho për një orë pas ngrënies, para se të shkosh për notim;

dh) Të miturit nën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeç duhet të jenë gjithmonë nën mbikëqyrjen e më të rriturve;

e) Mos u hidh nga shkëmbinj apo platforma, përveç vendeve të autorizuara me sinjalistikë;

ë) Ndiq udhëzimet e vrojtuesit (rojës së shpëtimit të jetës);

f) Mbaj pastër mjedisin;

g) Në rast emergjence në det, telefono 112.

8. Lejohet aktiviteti i dhënies me qira të pedaloneve apo i mjeteve të tjera ujore jomotorike dhe përdorimi i tyre duhet të bëhet jashtë zonës së notimit, bazuar në aktet nënligjore në fuqi.

9. Lëvizja e motorëve të ujit apo varkave motorike duhet të bëhet nga vendqëndrimet dhe korridorët hyrësë/dalëse, të miratuara nga NJVV-ja përkatëse.

10. Ofrimi i shërbimeve dhe plotësimi i kushteve, të përmendura më sipër, bëhet me shpenzimet e mbajtësit të autorizimit të stacionit të plazhit.

Neni 10 Detyrat e vrojtuesit të plazhit

Vrojtuesi i plazhit ka si detyrim:

a) të ketë njohuri për kuadrin ligjor të funksionimit të stacionit të plazhit, teknikat e shpëtimit dhe dyluftimit në ujë, dhënien e ndihmës së parë mjekësore, për hidrometeorologjinë, karakteristikat e brigjeve shqiptare dhe rrymat ujore në to, si dhe për sigurinë e mjedisit ujor, me referim të veçantë për të njohur faktorët e rrezikshëm që mund të jenë të pranishëm në ujë;

b) të jetë i angazhuar ekskluzivisht në shërbim të vrojtimit-shpëtimit dhe të jetë i pranishëm përgjatë gjithë kohës pranë pikës së vrojtimit, përjashtuar rastet emergjente;

- c) të mbajë të veshur uniformën e vrojtuesit me ngjyrë të kuqe gjatë shërbimit. Uniforma ka të shkruar në pjesën e përparme logon, në krahun e majtë simbolin e flamurit shqiptar, në krahun e djathtë numrin e matrikullës dhe në pjesën e pasme, në mënyrë të dukshme qartë, “Vrojtues plazhi” dhe “Lifeguard”;
- ç) të sinjalizojë pranë organeve kompetente, në rastet kur verifikohen kundërvajtje në territorin e stacionit të plazhit dhe në hapësirën ujore përballë tij;
- d) të kujdeset periodikisht për sinjalistikën ujore dhe territoriale të stacionit të plazhit dhe të bëjë zëvendësimin e materialeve të konsumuara në rutinë e ndihmës së shpejtë mjekësore, si dhe të mbajë në eficiencë mjetet e shpëtimit;
- dh) të ketë certifikatën dhe kartën ekuivalente të certifikatës, brenda afatit të vlefshmërisë, lëshuar nga qendrat e formimit profesional. Rinovimi i saj bëhet sipas rregullores së subjektit certifikues, me qëllim monitorimin e aftësive fizike, mendore të vrojtuesit.

Neni 11 Kritere të përgjithshme për strukturat në stacionet e plazhit

1. Strukturat dhe pajisjet e përdorura në stacionin e plazhit, përveç instalimeve sanitare publike dhe pikat e vrojtimit, duhet të çmontohen me përfundimin e afatit të parashikuar në kontratë për sezonin e plazhit të vitit respektiv, për t'i kthyer plazhit karakterin e tij natyror.
2. Strukturat e përdorura duhet të jenë:
 - a) struktura lehtësisht të çmontueshme, të realizuara me elemente, të tilla, si druri, panele të parafabrikuara të lehta, mbulesa të lehta, PVC, që nuk e dëmtojnë mjedisin në momentin e zhvendosjes; b) pajisje të lëvizshme, të instalueshme vetëm për periudhën e sezonit të plazhit dhe të cilat mund të hiqen me mbylljen e tij, si çadra, krevate plazhi, tavolina, akseset për të shkuar në det, struktura të vogla prej druri etj.;
 - c) struktura të sigurt, të kenë sistemet e montimit me bulona, strukturat e shërbimeve mund të jenë të përkohshme.
3. Në stacionet e plazheve mund të ketë 3 tipologji çadrash:
 - a) me kashtë;
 - b) me pëlhurë, tekstil;
 - c) tendë kashte apo pëlhure.
4. Brenda brezit të shërbimeve mund të realizohen këto struktura: kioskë menaxhimi për plazhin, kabina, shërbime higjienike, depo, pika vrojtimi, hapësirë për rojën e plazhit në rastin e plazhit publik, strukturë shërbimi/bar, hapësirë për fëmijët, hapësira relaksimi me tavolina, hapësirë për vendosjen e biçikletave. Materialet që lejohen të përdoren për këto struktura janë: dru, kashtë, kallama, tenda të lehta, struktura të çmontueshme, në mënyrë që të magazinohen gjatë sezonit të dimrit dhe të transportohen përgjatë zonës bregdetare, në rast nevojë.

❖ Bazuar në VKM nr.60 datë 28.01.2026 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.649 , neni 6/1

1. Këshilli bashkiak, përpara fillimit të çdo sezoni turistik, mund të miratojë me vendim çmimet maksimale për secilën zonë bregdetare në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, të cilat shërbejnë si kufi maksimal për negocimin dhe zbatimin e çmimeve nga subjektet private. Në mungesë të këtij vendimi, çmimi maksimal përcaktohet ndërmjet bashkisë dhe subjektit privat, në përputhje me parimet e konkurrencës, proporcionalitetit dhe interesit publik.

2. Çmimet maksimale përcaktohen në mënyrë të diferencuar sipas zonave, duke marrë në konsideratë nivelin e zhvillimit turistik, aksesueshmërinë, intensitetin e kërkesës, standardin e shërbimit dhe interesin publik.

3. Çmimet maksimale të dakordësuara bëhen pjesë përbërëse dhe detyruese e kontratës së nënshkruar ndërmjet njësisë së vetëqeverisjes vendore, Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe subjektit privat e nuk mund të tejkalohen gjatë të gjithë periudhës së vlefshmërisë së kontratës.

4. Tejkalimi i çmimeve maksimale përbën shkelje kontraktore dhe shkak për vendosjen e masave administrative dhe/ose zgjidhjen e kontratës.”

Pra në zbatim të ndryshimeve ligjore, analiza për përcaktimin e Tarifës së Shërbimit për Plazhet Publike të tarifuar nga Njësia e Vetëqeverisjes Vendore është kryer në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 60 datë 28.01.2026 Neni 6 , pika I ku citohet se:

Njësia e vetëqeverisjes vendore (në vijim “NJVV”) është përgjegjëse, për:

a) administrimin dhe menaxhimin e hapësirave të plazhit publik të tarifuar nga Bashkia Vlorë .

Bazuar nga informacioni i dhënë nga specialist Inxhinjeri/topograf të Drejtorisë së Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve rezultonë se plazhi i lungomares është i kategorizuar sipas tipologjisë së mëposhtme:

Plazhi “ Lungomare” ka sipërfaqe metra katror (m2) (Sipas hartës së miratuar me VKB Nr.25, datë 28.02.2026.

Nr.	Tipologjia e Plazhit	Sipërfaqe M2
1	Publik	15471 m2
2	Publik I Tarifuar Nga Bashkia Vlorë	18176 m2
3	Menaxhuar	1208 m2
4	Kontratë 3-4-5 Vjeçare	9428 m2
	Totali	44283 m2

Plazhi “Lungomare” në sipërfaqe metra linear (mL) (Sipas hartës së miratuar me VKB.25, datë 28.02.2026)

NR	Tipologjia E Plazhit	Gjatësi Ml
1	Publik	588 mL
2	Publik I Tarifuar Nga Bashkia Vlorë	590 mL
3	Menaxhuar	40 mL
4	Kontratë 3-4-5 Vjeçare	434 mL
	Totali	1652 mL

Lidhur me kategorinë objekt propozimi “ Plazh publik i tarifuar nga Bashkia Vlorë”, sipërfaqja totale plazh publik i tarifuar me sipërfaqe 18,176 m2 është i ndarë në 8 parcela. Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur pasqyra me parashikimin lidhur me kosto – përfitime si dhe pasqyra të ardhura shpenzime .

NR	Përshkrimi	VLERA TOTALE
1	Paga/sigurime punonjësish(total 16punonjës)	4 196 021
2	Shpenzime operative(bova,litar,flamur,kuti ndihme,kasa,kulla vrojtimi)	2 445 450
	VLERA TOTALE	6 641 471

Nisur nga te dhënat e mësipërme për vitin 2026 ku do të kryhet ky shërbim , kostua e përdorur për realizimin e këtij shërbimi është **6 641 471** lekë.

Tabelës së mësipërme për sipërfaqen totale prej 18176 m² plazh publik e cila mbulohet me 1818 çadra nëse çmimi për një çadër do të jetë jo më shumë se 50 % e vlerës së tregut sipas VKB Nr.25, datë 28.02.2026 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Vlorë, për vitin 2026 dhe tarifës së shërbimit për zonën e plazheve publike të administruara dhe të tarifuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore”

Për sa më lart në zbatim të VKB së mësipërme është ngritur grupi i punës me Urdhër të Brendshëm Nr. 267, datë 17.02.2026 , Nr. 3594 Prot, datë 17.02.2026, të Kryetarit të Bashkisë i cili ka kryer testim tregu dhe ka marrë nga subjektet të cilat operojnë në zonën e Lungomares si “Stacion Plazhi ofertat e mëposhtme:

1. Subjekti 1-76 çadër/shezllone me çmim 1500 lekë
2. Subjekti 2-99 çadër/shezllone me çmim 1000 lekë
3. Subjekti 3-80 çadër/shezllone me çmim 1500 lekë
4. Subjekti 4-24 çadër/shezllone me çmim 1500 lekë
5. Subjekti 5-50 çadër/shezllone me çmim 1500 lekë
6. Subjekti 6-20 çadër/shezllone me çmim 1500 lekë

Mesatarja e ofertave të marra nga subjektet e testura është 1417 lekë

Duke zbatuar VKB.25, datë 28.02.2026 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Vlorë, për vitin 2026 dhe tarifës së shërbimit për zonën e plazheve publike të administruara dhe të tarifuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore” ku vlera për një çadër nuk duhet të jetë jo më shumë se 50% e vlerës së tregut, vlera për një çadër sipas analizës së bërë është $1417/2 = 708$ lekë.

Nisur nga sa më lartë propozojmë me anë të këtij projekt -vendimi që çmimi për një çadër-shezllon në zonat publike të tarifuar nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të jetë 700 lekë.

Të ardhurat që do të përfitohen nga dhënia e një çadre në ditë do të jetë **1 272 600** lekë, duke marr parasysh që çadrat do të përdoren minimalisht vetëm një herë në ditë.

Referuar vlerave të mësipërme duke u bazuar dhe në një mesatare ditësh prej 90(ditë) të sezonit turistik në Vlorë të ardhurat e mbledhura në fund të sezonit do të jenë si më poshtë:

Nr	Çadrat Total	Cmime Reference	Vlera E Ardhur Për Një Çadër	Mesatarja E Dhënies Së Çadrës	Vlera E Ardhur Ditore	Total Sezoni(90 Ditë)	Vlera Totale E Ardhur Në Fund Sezoni
1	1818	700	1 272 600	1	1 272 600	90	114 534 000

Të ardhura nga aktiviteti	114 534 000
Shpenzime	6 641 471
Fitim/humbja e sezonit	107 892 529

Referuar dhe dispozitave ligjore ligjore që shoqërojnë Projekt-Vendimin që po ju paraqesim paraprakisht kërkohet vendimarrja e Këshillit të Bashkisë Vlorë “Për miratimin e e tarifës së ofrimit të shërbimit për zonën e plazheve, të administruara dhe të tarifuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore’.

Ndërkohë për tarifa për zënien e hapësirës publike me qëllim biznesi për zonën e Plazhi i Vjetër-Zvërnec dhe Uji i Ftohtë-Radhimë-Orikum do ti referohet tarifës së përcaktuar në VKB-në Nr. 96, datë 07:12.2023 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë, per vitin 2024", pra ngelen të pandryshuara.

Në kushte të tilla, kërkohmë nga ana juaj të miratoni këtë Projekt- Vendim ku propozojmë vendosjen e çmimit prej 700 lekë për çadër dhe shezllon.

Drejtore
Bruna Bisholla

